



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel.028 571343

DATE/A:	21.09.2020
REFERENC-Ë:	210/20
PËR/ZA/TO:	Të gjithë të interesuarit për aplikim për "Furnizim me Makina Mbjellëse për Misër"
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Z. Miran Halili
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim

Njoftohen të gjithë të interesuarit se mund të aplikojnë në thirrjen e Komunës së Vushtrrisë - **DEBPZHR**-së për **Përfitim** e **Makinës Mbjellëse** për Misër, aplikacioni merret në **DEBPZHR**.

I. Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:

1. Të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë;
2. Të jetë i moshës 18-65 vjeçar;
3. Të jetë kultivues i kulturës të Misërit;
4. Të posedoj traktorë adekuat për përdorim e makinës me minimum 42 KF;
5. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar më parë (tri vitet e fundit);
6. Aplikuesi duhet të participoj në financimin e projektit nëse përzgjidhet si përfitues në vlerën prej **700.00€**.

II. Përzgjedhja e përfituesit do të bëhet duke u bazuar në kriteret e më poshtme;

1	Kategoritë e familjeve me jetim, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidë dhe veteranë.	4 pikë				
2	Fleta poseduese në emër të aplikuesit	5 pikë				
3	Familjet me distancë të largët nga qendra e qytetit	4 pikë	1-7 km 1 pikë	8-10 km 2 pikë	11-15 km 3 pikë	Mbi 15 km 4 pikë
4	Familjet me numër më të madh të anëtarëve të papunë	4 pikë	1-2an. 1 pikë	3-4an. 2 pikë	5-6an. 3 pikë	Mbi 6 an. 4 pikë
5	Familjet me numër të madh fëmijësh	4 pikë	1-2fëm. 1 pikë	3-4fëm. 2 pikë	5-6fëm. 3 pikë	Mbi 6fëm. 4 pikë
6	Fermeri që posedon sipërfaqe të mbjellura me kulturën e misrit (dëshmi nga subvencionet).	5 pikë	1-3 ha 1 pikë	4-7 ha 2 pikë	8-10 ha 3 pikë	Mbi 10 5 pikë
7	Kualifikimi-	4 pikë	4 pikë	Fakulteti-drejtimi bujqësisë		
			2 pikë	Shkolla e mesme bujqësore		
8	Kapaciteti i aplikuesit për jetësimin e grantit (vlerësimi nga terreni)	5 pikë				
	Numri total i pikëve	35 pikë				

Vërejtje:

- Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve dhe tentimit për mashtrim do të aplikohen masa ndëshkimore duke mos i dhënë mundësi përfitimi për tre vitet e ardhshme.
- Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar nuk do të pranohen për shqyrtim.

Dokumentet për aplikim:

1. Aplikacioni i plotësuar;
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Vërtetimin për kryerjen e obligimeve komunale (tatimi në pronë, mbeturinat);
4. Certifikata pronësore (fleta poseduese)-kopje;
5. Certifikatën e bashkësisë familjare- jo më e vjetër se 6 muaj(edhe kopje);
6. Dëshminë e sipërfaqeve të mbjellura me misër (raportin e subvencioneve);
7. Dëshminë për traktorë adekuat për përdorim e makinës me minimum 42 KF;
8. Dëshminë për përgatitjen profesionale (nëse posedon)-kopje;
9. Dëshminë për kategoritë e familjeve me jetim, familjeve të dëshmorëve; martirëve, invalidë dhe veteranë.



Aplikohet në zyrën pritëse të Komunës.

Afati i fundit për aplikim: 05/10/2020 ora 15:30.